



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.365/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (SRB), me seli në Leposaviq, kundër Listës Serbe (LS), me seli në Mitrovicë të Veriut dhe kompanisë “MTS DOO” Kosovska Mitrovica, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet e pasafatshme ankesa**, e identifikuar me numër Anr.365/2019, e datës 09.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (SRB), me seli në Leposaviq, kundër Listës Serbe (LS) me seli në Mitrovicë të Veriut dhe kompanisë “MTS DOO” Kosovska Mitrovica, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore.

## A r s y e t i m

Me datë 09.10.2019 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (SRB), me të cilën pretendon se subjekti politik Lista Serbe (LS), dhe kompania “MTS DOO” Kosovska Mitrovica, e cila është e regjistruar në sistemin e Republikës së Kosovës për punët e telekomunikacionit, gjatë ditës së votimit rreth orës 07:45 dhe 14:08, ka dërguar tek të gjithë përdoruesit e MTS në Kosovë, mesazhin sistematik me përmbajtje “*Serbia thërret për të dhënë votën tuaj. Votoni për Listën Serbe, nr.135*”, krejt kjo në interes të Listës Serbe, me qëllim që ti drejtoj apo ndikojë qytetarët se kujt duhet të i’a japin votën, kështu duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatësisht duke thyer heshtjen zgjedhore.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës, ka gjetur se ankesa e paraqitur nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (SRB), kundër subjektit politik Lista Serbe (LS), dhe kompanisë “MTS DOO” Kosovska Mitrovica, është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: “*Për të gjitha*

*çëshitet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”.. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi ankesën e ka paraqitur pranë PZAP-it me datën 09.10.2019, ndërsa afati prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë ka qenë me datën 07.10.2019, që do të thotë se ankeuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”.*

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 365/2019 me datë 10.10.2019

**Kryesues i Panelit**  
Adnan Konushevci



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta në ankesës.***